



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 55/16

Prishtinë, më 10.5.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi-zv, ministër i financave, Flutra Blakqori-Zyrtare Ligjore në MF.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Fjolla Uka – monitoruese KDI, Sanije Berisha nga OSCE, Petrit Balaj - Shoqata e Bankave të Kosovës, Ali Krasniqi-Shoqata e Bankave të Kosovës, Albulena Mavraj- Gazetare Epoka e Re, Florina Ejupi-monitoruese nga BIRN,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajur e Komisionit dt.10.5.201**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit**
- 4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**
- 6. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**
- 7. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**
- 8. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-05/L-083 për Falimentimin dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**
- 9. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

- 10. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;**
- 11. Shqyrtimi i Kërkesës së Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm për caktimin e pagës për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës;**
- 12. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalet nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 10.05.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbali miratoheh pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit

Kryetari - me këtë projektligj përcaktohen masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Pas diskutimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - Raporti është proceduar me kohë ashtu siq e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në raport janë paraqit të dhenat e shpenzimeve të viti 2015 dhe në bazë të kësaj realizimi të hyrave është gjithsej pranimet apo të hyrat e realizuara në shumë prej 1,690,349,000 euro dhe paraqesin 96% e të hyrave të planifikuara , krahasuar me vitin 2014, kemi një rritje prej 16%.

Agim Krasniqi - në vitin 2014 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2015 ku plani vjetor i pranimeve ka qenë 1 miliard e 761 milion euro, kurse plani vjetor i pagesave ka qenë 1,722,138,000 euro, duke përfshirë edhe të hyrat e bartura nga viti 2014. Pranimet në vitin 2015, duke mos i përfshirë grantet e përcaktuara të donatoreve dhe fondet me mirëbesim janë 1,690,349,000 euro dhe paraqesin 97% përgjithshme vjetore te planifikuara. Të hyrat e përgjithshme në krahasim me vitin 2014 janë rrite për 9.3 %, ku kryesisht në këtë kanë kontribuar të hyrat e rregullta tatimore. Të hyrat nga taksat kufitare gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 951.8 milion euro ose 106% e planifikimit vjetor, kurse me krahasuar me vitin paraprak pason me një rritje prej 9.3%, ku përveç rritjes në vlerë edhe rritjes së importeve, kjo rritje ka qenë e shtyrë në efektin e ndryshimeve në normën e akcizës në disa produktet që i nënshtrohet kësaj takse si dhe fillimi e re të pakos fiskale. Në të hyrat kufitare një kontributet pozitivë kanë dhënë të hyrat nga akciza, pasuar nga të hyrat e mbledhura nga TVSH dhe taksa doganore. Të hyrat e arkëtuara në vend përgjatë kësaj periudhe kanë regjistruar 332.8 milion euro ose 97.9% të planifikimit vjetor, që krahasuar me vitin paraprak është me rritje prej 9.6%. Edhe këtu vlenë të theksohet se ky trend ka ardhur për shkak të implementimit të pakos së re fiskale dhe përshkallzimit të TVSH-së. Të hyrat vetanake komunale në këtë periudhe kanë shënuar një ramje prej 4.9% në krahasim me vitin paraprak, rrjedhisht të hyrat vetanake komunale kanë qenë me shumën prej

57,9 milion euro ose 78%, kjo është pjesa që është realizu me se paku krahasim me gjitha te hyra te tjera hyrat vetanake komunale. Te hyrat vetanake te nivelit qendror në përgjithësi kanë arritur nivel të kënaqshëm dhe kanë arritur në shumën prej 49.3 milion ose 123.3% e planit vjetor. Në këtë kategori perfshihet licenca e liberalizimit e tregut, e telefonisë mobile që ka qenë 14.8 milione euro. Në anën tjetër të hyrat tatimore të nivelit qendror të krahasuar me planin janë realizuar 49.4 milion ose 3% më shumë se sa plani.

Shpenzimet buxhetore kanë shenuar rritje prej 5.7% krahasuar me vitin 2014 dhe kanë arritur shumën prej 1,552 milion euro. Pagat dhe medijtjet janë shpenzuar 525 milion euro ose 94% krahasuar me vleren totale për këtë kategori, e kjo ka shenuar një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej 7.4%. Kryesisht kjo i atribuohet implementimit te komponentes së përvojes së punes si pjesë e kontratës kolektive si dhe efekteve vjetore të pages që ka ndodhur në prill te vitit 2014. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve kanë arrit vlerën prej 205.5 milion euro ose 96.5% të buxhetit të planifikuar. Për kategori ka pas ulje te shpenzimeve krahasuar me vitin 2014. Shpenzimet per subvencione e transfere kanë arrit vlerën prej 418,1 milion euro ose 95% të buxhetit të planifikuar dhe janë prej 15.7% më të larta në krahasim me periudhën e vitit paraprak. Në këtë kategori kursimet apo mosshpenzimet kanë ndodhur për shkak të voneses në implementim e ligjit për veteranët e luftës, i cila ka filluar me u ekzekutuar ne tetor të vitit 2015. Shpenzimet kapitale kanë vlerë prej 403.9 milion euro ose 88.3% e buxhetit te planifikuar, krahasuar me vitin paraprak është një rritje e lehtë prej 1.8%. Mosrealizimi i planifikuar i kësaj kategori vjen kryesisht si pasojë e mosrealizimit e disa projekteve që kanë qenë të planifikuara te financohen me financime të jashtëm apo bashkfinancim. Gjendja e fondeve deri 31 dhjetor janë 256.5 milion euro, pjesë e këtij bnilanci janë fondi i donatoreve prej 11.5 milion euro, te hyrat vetanake që mbahen 21.8 milion euro, fondi per mirëbesime 8.6 milion euro, të hyrat e dedikume që janë per AKP në 0.8 milion euro dhe fondet tjera per mirbesim jane 12.7 milion euro. Pra viti 2015, duke përfshirë pagën e dhjetorit është me deficit buxhetor prej 1,3 % e GDP , ndersa bilanci bankar ka qenë dukshem me i lart se vitit paraprak.

Besa Gaxherri – theksoi se raporti përshkruan në detale të hyrat dhe shpenzimet. Po shifet se ka rritje te hyrave prej Doganave dhe ATK-së, por edhe rritje të shpenzimeve. Natyrisht shpenzimet për paga e subvencione janë me te larta se të tjerat dhe këtë trend duhet me u mundue me e permirësue. Shqetësuese janë të hyrat nga komunat. Prej të gjitha komunave vlenë me e permend se perjashtim per performancë pozitive krahasur me vitin paraprak kanë shënuar: Obiliqi, Podujeva, Prizreni, Rahoveci, Istogu, Kaqaniku, Novoberda, Parteshi dhe Ranillugu, ndersa komunat tjera jane mbrapa. Sa i përket shpenzimeve, investimet kapitale janë realizuar -2 % krahasuar me vitin paraprak, subvencionet janë rrit rreth 50 milion euro ose 16%, që ka të bëjnë me përkrahjen e bujqesisë, pagesat për sektorin e blegtorisë që është 12 milion euro, pagesat per kulturë bujqesore që është 17 milion euro, që janë pozitive për arsye se unë i konsideroj si investime kapitale se presim me na kthye pastaj. Ju lutem të na sqaroni qfarë është shpenzimi “ristukturimi potencial fizik” prej 14,906,000 euro. Sa i përket numrit të të punësuarve në komuna, shofim se disa komuna e kanë tejkaluuar numrin e të punësuarve të lejuar, ju lutem të na jepni një sqarim si kanë ndodhur këto tejkalime? Sa i përket shpenzimeve të rrymës ato janë të larta prej 2 milion euro dhe çdo vit është këto shpenzime janë shtuar për 1 milion euro dhe këto janë vërtetë shumë?

Agim Krasniqi - sqaroi se deri më tani, ka ndodhur një laramani në realizimin e të hyrave nga komunat. Por në këtë vit jemi duke i përgaditur vlersimet per vitin e ardhshem, ku do të jenë disa faktorë që do të ndikojn në planifikim më të mirë të të hyrave për buxhetin komunal. Tek shpenzimet kapitale është e vërtete nese e marrim vitin 2014 shihet se janë ulur, por ne nuk mund të themi se kemi realizim të dobët të shpenzimeve kapitem kur ato janë realizuar 88% dhe pjesa tjetër që nuk është realizuar ka të bëjë me financimin e projekteve prej kredimarrjes. Subvencionet dhe transferet janë rritur prej 13 milion euro në 50 milion, që përfshin edhe pjesën e përkrahjes për sektorin e bujqesise. Në pyetjen për shpenzimet “ristukturimi potencial” prej 14 milion euro, unë besoj që ka të bëjë me pjesën e ministrisë

se zhvillimit ekonomik lidhur me ndermarjet publike, që për disa projekte në këtë ministri por duhet te shikoj më saktësisht se për qfarë kanë të bëjnë. Rritja e pagave ka të bëjë me implementimit e pjesës së kontratës kolektive per pagesën e pervojës së punese e cila është diku 30 milion euro, dhe pjesa tjetër është për shkak të asaj rritjes së pagave që kemi pasur më herët. Është e percaktuar që ka me teper punetore në disa komuna dhe kjo është vetëm për shkak të normës dhe në asnjë rast nuk lejohet me u rrit numri i punetoreve të rregullt mbi ata që eshte e percaktuar me ligj të buxhetit. Disa kryetar të komunave po vazhdojnë punësimet me kontratë mbi vepër që është e ndaluar me ligj.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Raportin financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

5. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari – theksoi që projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Propozojë një amendament në tekstin e projektligjit që në nenin 22, pas paragrafit 2, të shtohet paragrafi i ri 3 me tekstin si në vijim: 3. Nëse prona e hequr nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në bazë të procedurave të parapara me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni i bartet subjektit investues me vendim të Qeverisë, shuma e kompensimit do t'i paguhet Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit e mban shumën e kompensimit me mirëbesim me qëllim të përmbushjes së të drejtave të punetoreve si dhe kërkesave të pronarëve dhe kreditorëve lidhur me pronën përkatëse. Shpërndarja e këtij kompensimi duke përfshirë sipas rastit kthimin e suficitit në Qeveri do të bëhet në përputhje me të njëjtat ligje dhe rregulla që zbatohen për shpërndarjen e fondeve të tjera që mbahen në mirëbesim nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Ndërkaq amendamenti 32 i komisionit funksional të mos përkrahet.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin Nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 22, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si në vijim:

3. Nëse prona e hequr nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në bazë të procedurave të parapara me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni i bartet subjektit investues me vendim të Qeverisë, shuma e kompensimit do t'i paguhet Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit e mban shumën e kompensimit me mirëbesim me qëllim të përmbushjes së të drejtave të punetoreve si dhe kërkesave të pronarëve dhe kreditorëve lidhur me pronën përkatëse. Shpërndarja e këtij kompensimi duke përfshirë sipas rastit kthimin e suficitit

në Qeveri do të bëhet në përputhje me të njëjtat ligje dhe rregulla që zbatohen për shpërndarjen e fondeve të tjera që mbahen në mirëbesim nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 32.
4. Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti 32, të hiqet.

6. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Megjithatë për disa nene që kanë të bëjnë me natyrën financiare dhe buxhetore të ZRRE-së, propozojë dy amendamente: Në nenin 22, në paragrafin 1, në rreshtin e tretë, pas fjalës “përcaktohet”, shtohen fjalët“ në nenin 19 dhe”. Si dhe Në nenin 22, paragrafët 2, 3 dhe 8, hiqen.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamente në Projektligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 22, në paragrafin 1, në rreshtin e tretë, pas fjalës “përcaktohet”, shtohen fjalët“ në nenin 19 dhe”.

Amendamenti 2

Në nenin 22, paragrafët 2, 3 dhe 8, hiqen.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-05/L-083 për Falimentimin dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-083 për Falimentimin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Megjithatë këtu kemi një qështje që ka të bëjë me bordin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si ndërmarrje publike, i cili deri më tani ka qenë nën qeveri, tani komisioni funksional me amendamete e ka propozuar të jetë në Kuvend. Megjithatë, ata nuk kanë bërë rregullim për mënyrën e caktimit të pagave të bordit që tani po kalon në Kuvend. Propozojë që të bëjmë një rekomandim për komisionin funksional, për këtë qështje si në vijim: Komisioni Funkcional që në amendamentin 15 që i referohet nenit të ri 14, pas paragrafit 15, të shtoj një paragraf i ri, me tekstin si vijon:

“Paga e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit caktohet nga Kuvendi, deri në miratimin e Ligjit përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë.”

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Komisionit Funkcional që në amendamentin 15 që i referohet nenit të ri 14, pas paragrafit 15, të shtohet një paragraf i ri, me tekstin si vijon:

“Paga e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit caktohet nga Kuvendi, deri në miratimin e Ligjit përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë.”

10. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Shqyrtimi i Kërkesës së Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm për caktimin e pagës për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

Kryetari – ne kur kemi shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, nuk jemi pajtuar me propozimin e komisionit funksional që paga e auditorit të përgjithshëm të jetë ekulivalente me pagën dhe shtesat e kryetarit të gjykatës kushtetuese dhe kemi propozuar amendamentin tonë, ku kemi propozuar që paga e auditorit të caktohet nga Kuvendi deri në miraimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publik. Në bazë të informacioneve që kemi, komisioni funksional nuk e ka përkrahur propozimin tonë dhe tani do të kemi dy propozime për këtë çështje në senacën kur të votohen amendamentet. Unë propozoj që kërkesa të shtyhet deri sa të miratohet ligji, për të parë se cili propozim do të kalojë.

Me propozim të kryetarit, Komisioni njëzëri vendosi që kërkesa së Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm për caktimin e pagës për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, të shtyhet në një mbledhje tjetër të komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani